



## RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi <b>Barim ZEKAJ</b>	Data e autorizimit të ekspertit <b>13.12.2022</b>	Data e dorëzimit të raportit <b>20.12.2022</b>	Nr. i lëndës: <b>725/22</b>
---	--	--	--------------------------------

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.12.2022, OE "N.P.T. "F N W"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 725/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "N.T.SH CREATIVE DESIGN"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me spaleta ri-tender" me nr. të prokurimit: 214-22-10000-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornize, me një Operator Ekonomik: furnizim, kriteri i dhënies së kontratës, Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin e përgjegjshëm më të ulët, vlera e parashikuar e kontratës: 119,519.40 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së - Qëllimi;

Neni 6 i LPP-së - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi; Neni 28 - Specifikimet teknike;

Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve; Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënie të Kontratës;

Neni 72 i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Autoritet kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit na ka dërguar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm me dt. 07.11.2022, ku na keni informuar se e keni rekomanduar për kontratë OE: "N.T.Sh. Creative Desing".

Ne me dt. 09.11.2022 me email kemi kërkuar qasje në dokumentet dhe mostrat të OE fitues.

Me dt. 12.11.2022 kemi bërë kërkesën për rishqyrtim pranë AK dhe me dt. 22.11.2022 kemi pranuar përgjigjen mbi kërkesën tonë dhe me të janë hudhur poshtë të gjitha kërkesat tona si të pabazuara. Eshtë

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.P.T. "F N W" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me spaleta ri-tender, me numër të prokurimit: 214-22-10000-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia Kosoves.

per tu quditur fakti qe ne pergjigjen per kerkesen per rishqyrtim kemi kerkuar sqarim se pse disa produkte te kerkuara nuk jane si ne foto ndersa pergjigja e AK ka qene se fotot jane paraqitur vetem sa per ilustrim.

- Kompania e cila eshte rekomanduar per kontrate: OE: "N.T.Sh. Creative Desing & RA-TA", mostrat e kesaj kompanie nuk jane ne perputhje me specifikat e kerkuara ne Aneksin 1. Me poshte po ju paraqesim keto mos perputhje Gjatesia qendrore e spaletave dallon prej kerkeses ne specifikat teknika Aneks 1, ku eshte kerkuar te jete 140mm te te gjitha gradat ndersa tek gradat me rreth (prej Nr:6 deri Nr: 13) asnjera nuk e kan dimensionin e kerkuar 140mm, te gjitha kan qen me te vogla 135mm deri 138mm.
- Yllat gjashtecepesh te cilat duhet te jene 17 mm, dallojn me madhesi horizontalisht dhe vertikalisht, ne nje ane jane 15mm ndersa anen tjeter 17mm
- Tek gradat prej Nr: 1, 3, 4, 5, yllat me rreth nuk jane vendosur ne mesin e grades, kur behet matja prej anes se djathte dhe te majte (pra qepja nuk eshte simetrike) edhe ketu kemi marr njepergjigje qesharake e cila deshmon edhe njehere diskriminimin tone ne kete vleresim.
- Trashesia e shiritave te qendisura ne disa spaleta nuk eshte e njejte si ne anen e majte ashtuedhe ne anen e djathte. (nuk eshte e vertete pretendimi I AK se se eshte njejt se ne kemi berematjen e spaletave te fituesit)
- Shiritat e qendisura te gradave dallojn prej dizajnit standard te paletave, nuk eshte deri ne cepin e spaletes siq eshte kerkuar ne ilustrime tek Aneks 1. ( Kjo eshte nje gabim shum i madh e cila nuk ben te tolerohet kursesi, por AK ja eshte pergjigjet se ato jane vetem ilustrime, kjo pergjigje na jep te kuptojme se edhe ilustrimet e dokumentuara ne kete rast po perdoren nga AKja per manipulim dhe diskriminim te Operatorve ekonomik, ne kete rast neve.
- Per qepjen (bashkimin e spaletava) eshte perdorur peni i kaltert (duhet te jete kaltert mbyllt) ecila verrehet qarte kur shikohet nga anash ne paletat (Nr: 1, 2, 3, 4,5)
- Shiritat mrapa spaletave (te shenuar ne Anex 1 te Dizajni i specifikave me emrin 2 membranate nderthurrura, dhe te **Materialet tjera** specifikohet "thurra 20mm thurrije ngjyre blu e erret por e nderthurrur" dhe te **dizajni I spaletave** specifikohet poashtu "Në pjesën e poshtme 2 membrana të ndërthurura duhet të futen në palën anësore", keto shirita saktesisht jane kerkuar te jene 20mm, ndersa tek spaletat e fituesit disa jane 15mm dhe disa 17mm, te cilen fakt poashtu e ka mohuar AK ja.
- Peni i perdorur ne grada Nr: (8,9,10,11,12,13) nuk eshte  
"(POLYNEON N° 40 – Polyester ari (support) 1772 = PANTONE 124 C)." siq kerkohet shume qarte ne specifika. Kompania fituese ka perdorur penin ARI METALIK e cila nuk perputhet fare me specifika edhe perseri eshte shpallur fitues, mund te deshmojme se katalogu I MADEIRA POLINEON no40 nuk permban fare ngjyra metalike si ajo as afer me penin qe ka perdorur fituesi, gabim katastrofal I kompanise fituese ose specifikat jane shenuar gabim perte hutuar operatoret tjere, si ne qe kemi perdorur penin e kerkuar si dhe e kemi bashkangjitur edhe penin e cekur me firme, me emer me gjeth bobine tek mostrat tona.
- Ne letren standarte drejtuar kompanise tone na keni njoftuar qe kompania jone nuk i ploteson specifikat e dosjes se tenderit, konkretisht ne mostrat e dorezuara. AK ka listuar 13 arsye per eliminimin tone te cilat

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.P.T. "F N W" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me spaleta ri-tender, me numër të prokurimit: 214-22-10000-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia Kosoves.

nuk qendrojnë aspak. Në mostrat e dorëzuara i kemi paraqitur sipas kërkesave dhe standarteve të kërkuara në FTD, por ekziston mundësia që kur janë bërë matjet nga Komisioni Vlerësues, ka bërë ndonjë gabim eventual në zgjatjen e tyre ose shkurtimin, pasivlerësimi nuk është bërë nga një komision profesional ose laborator i pavarur.

Gjithashtu në kemi verëjtur dhe kërkojmë që të deshmohet se në mostrat tona është ushtruar presion fizik pasi duket qartë deformimi i tyre në disa pjesë, pasi që mostrat janë nga pelhura dhe mund të zgjaten apo shkurtohen mvaresisht nga tërheqja e tyre fizike. Nuk qendron fakti që në kemi dorëzuar mostrat sipas specifikave dhe ato janë në përputhje në çdo mm në kërkesat në FTD, sepse janë punuar me makina kompjuterike me precizitet 0.01 mm.

Firma jone i posedon këto makina kompjuterike një kohë të gjatë dhe në me heret kemi dorëzuar në Policinë e Kosovës grada të këtij lloji kur kanë qenë sasi të shume me të vogla, por për sasi të mëdha me vite anulohet ky tender dhe në kemi diskriminuar edhe pse kemi qenë kryesisht me çmim më të lirë, këtu duket haptas diskriminimi ynë si firmë prodhuese vendore dhe profesionale për këto produkte. Ju lutem nese mundëni edhe të qaseni në historinë e këtij tenderi (Spaletat për PK në) mund të analizoni edhe aty parregullsi të shumta. Jemi të hapur për çdo informata shtesë nëse keni diçka të paqartë dhe nëse mund të ju japim dëshmi dhe sqarimesh të për gjetjet dhe verëjtjet tona.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, sepse ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform këtij neni, pasi që mendojmë që tenderi jone nuk është vlerësuar konform kërkesave të dosjes së tenderit, prej një komisioni jo profesional ose plotësisht të njohur. Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënien e kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm** me çmim më të ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, gjë që ju e keni dëmtuar Bugjetin e Kosovës duke shpallur fitues një kompani të cilën ka çmim më të lartë.

Me këtë vlerësim dhe vendim AK na ka diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së sepse është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa në kemi diskriminuar, edhe pse kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe kemi ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, nuk kemi shpallur fitues të këtij tenderi, ndërsa në paragrafin 1 të neni 7 të LPP-së parashihet qartë *"Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*.

Autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondëve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondëve dhe burimeve të tjerat autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

## VENDIM

**APROVOHET** ankesa e OE "N.P.T. " F N W " si e bazuar, dhe lënda të kthehet në **RIVLERSIM** dhe gjatë rivlersimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së dhe N.P.T. "FNW" si OE i përgjegjshëm ekonomikisht me i favorshëm të rekomandohet për kontratë. Si dhe vlerësimi të bëhet nga një trup i pavarur profesional si Laborator i licencuar.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta.

#### KRITERET PËR VLERËSIM

<p>Kapaciteti ekonomik dhe financiar</p> <p>a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së, se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë prej jo më pak se 160,000.00 Euro,€</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>a) OE duhet te dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit.</p>
<p>Kapaciteti teknik dhe profesional</p> <p>a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar/ realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte ose te ngjashme për 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) minimum nje kontrat te përfunduar realizuar me sukses.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>a) Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit ( nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE, të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës. Vërejtje: Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve, kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat te lëshuara nga autoriteti i tillë.</p>
<p>b) Operatorët Ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë nga një mostër për secilin artikull sipas specifikacioneve teknike Aneksit 1 para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve në orën 14 00.</p>	<p>b) Mostrat duhen dorëzuar për secilin artikull para datës së pranimi të ofertave ora 14 00</p>

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.P.T. "F N W" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me spaleta ri-tender, me numër të prokurimit: 214-22-10000-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Policia Kosoves.

## RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

<p>2. N.P.T. "FNW" Tirana, PRIZREN 690218889</p>	<p>OE ka dështuar në specifikimet teknike si mëposhte:</p> <p><b>1. Shenja dalluese për Kadet Policor</b> Gjatësin jashtë thyerjes e ka bërë 108 mm, ndërsa duhet të jetë sipas specifikacioneve teknike 110.</p> <p><b>2. Grada Polic i Ri</b> Pjesa afër qafës 54 mm duhet të jetë sipas specifikacioneve teknike 55mm Rrethi i yllit gjashtëcepësh 19 mm duhet të jetë 18mm ndërsa vetë ylli 16 mm duhet të jetë 17mm Forma gjeometrike jo e rregullt ashtu siç është kërkuar me përmasa.</p> <p><b>3. Grada Polic</b> Rrethi i yllit gjashtëcepësh 19 mm duhet të jetë 18mm ndërsa vetë ylli 15 mm duhet të jetë 17mm Forma gjeometrike jo e rregullt ashtu siç është kërkuar me përmasa.</p> <p><b>4. Grada Polic i Lartë</b> Pjesa afër qafës 53 mm duhet të jetë sipas specifikacioneve teknike 55mm</p> <p><b>5. Grada Rreshter</b> Rrethi i yllit gjashtëcepësh 18 mm ndërsa vetë yllin e ka ofruar 16 mm duhet të jetë 17mm. Forma e yllit nuk është e rrumbullakët</p> <p><b>6. Grada Toger</b> Pjesa afër qafës 57 mm duhet të jetë sipas specifikacioneve teknike 55mm Rrethi i yllit gjashtëcepësh 15 mm, Forma e yllit nuk është e rrumbullakët</p> <p><b>7. Grada Kapiton</b> Pjesa afër qafës 57 mm duhet të jetë sipas specifikacioneve teknike 55mm Distanca prej brendësisë së shiritit rrethues deri te vendosja e yllit të parë 12 mm ndërsa OE ka ofruar 10mm Rrethi i yllit gjashtëcepësh 18 mm ndërsa vetë yllin e ka ofruar 16 mm duhet të jetë 17mm. Forma e yllit nuk është e rrumbullakët.</p> <p><b>Grada Kolonel Spaleta per Uniforme solemne</b> Pjesa afër qafës 56 mm duhet të jetë sipas specifikacioneve teknike 55mm Distanca prej brendësisë së shiritit rrethues deri te vendosja e yllit të parë 12 mm ndërsa OE ka ofruar 10mm si dhe distancën e ka ofruar 10mm (duhet të ishte 12) Rrethi i yllit gjashtëcepësh 18 mm ndërsa vetë yllin e ka ofruar 19 mm duhet të jetë 17mm. Forma e yllit nuk është e rrumbullakët</p> <p><b>11. Drejtori i Përgjithshëm</b> Dimensioni i spaletës – spaleta ka formën e një trapezi të rregullt me gjatësi qendrore prej 140 mm, e rrethuar me shirit ngjyrë të verdhë në trashësi prej 8 mm, ndërsa OE shiritin ka ofruar 9mm Distanca prej hartës dhe ajo ndërmjet tre (3) yjeve duhet të jetë 4 mm ndërsa distancën OE e ka ofruar 3mm, si dhe yjet gjashtë cepësh prej 17 mm ndërsa OE ka ofruar 20mm</p> <p><b>12. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm</b> Dimensioni i spaletës – spaleta ka formën e një trapezi të rregullt me gjatësi qendrore prej 140 mm, e rrethuar me shirit ngjyrë të verdhë në trashësi prej 8 mm, ndërsa OE shiritin ka ofruar 9mm Distanca prej hartës dhe ajo ndërmjet tre (3) yjeve duhet të jetë 4 mm ndërsa distancën OE e ka ofruar 2mm, si dhe yjet gjashtë cepësh prej 17 mm ndërsa OE ka ofruar 19mm</p> <p><b>13. Drejtor i Departamentit</b> Distanca prej hartës dhe ajo ndërmjet tre (3) yjeve duhet të jetë 4 mm ndërsa distancën OE e ka ofruar 3mm, si dhe yjet gjashtë cepësh prej 17 mm ndërsa OE ka ofruar 19mm</p> <p><b>OE nuk e ka sjellur dëshminë mbi Kapacitetin ekonomik dhe financiar</b> 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së, se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë prej jo më pak se 160.000.00 Euro, OE duhet të dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit; keni kërkuar sqarime me datë 17.10.2022 OE ka dërguar me kohë gjendjen, e cila ka qenë sipas kërkesës së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.</p> <p>OE ka plotësuar kërkesat Administrative</p>
<p>3. N.T.SH. CREATIVE DESIGN "Rr. Gjergj Balsha, Atheri Prishtine, Prishtine 690730007</p>	<p>Pasqitur e ka plotësuar edhe pjesën Teknike të cilat janë vlerësuar nga Anëtarët e komisionit teknik</p>

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.P.T. "FNW" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me spaleta ri-tender, me numër të prokurimit: 214-22-10000-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Policia Kosoves.



Dokument	ADAMI SH.P.K.	Tragim Rada - Furnizim me spaleta ri-tender	Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.SH. CREATIVE DESIGN RA-TA SH.P.K.
a) Operatori ekonomik dhanë të ofrimeve dhe të kontratave të realizuar me sukses kontratë të ngritjes së një ose të ngjashme për 3 (tri) vjet e fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) nënshkrimi një kontratë të përftuar realizuar me sukses.	Në pajtim Nuk është në pajtim Në pajtim	Në pajtim Nuk është në pajtim Në pajtim	Në pajtim Nuk është në pajtim Në pajtim
b) Operatori ekonomik ofrues dhanë të dorëzimit nga një mostër për secilin artikull sipas specifikacioneve teknike Anëtarit 1 para afatit të fundit për dorëzimin të tenderëve në orën 14:00.	Në pajtim	I pajtueshëm	Në pajtim

**Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:**  
**LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES**  
**Tenderi i përgjegjshëm me cimin me të lirë**  
 Sipas Nenit 60 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Rradhe	Lënda / grupi: Furnizim me spaleta ri-tender	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.SH. CREATIVE DESIGN RA-TA SH.P.K.	117 708,50

**IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS**

Nr.	Grupi:	Emri i tenderuesit të suksesshëm	Kodi postar	Adresa
1	Furnizim me spaleta ri-tender	Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.SH. CREATIVE DESIGN RA-TA SH.P.K.	10 000	Rr. Gjergj Balsha, Arbeni Prishtine

**DEKLARATË**

Komisioni i Vlerësimit të Tenderit, pas vlerësimit dhe ekzaminimit të tenderit OE "N.T.SH." CREATIVE DESIGN" Ka plotësuar kriteret Administrative. Përshtu e ka plotësuar edhe pjesën Teknike të cilat janë vlerësuar nga Anëtarët e komisionit teknik.

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

Operatori Ekonomik është pjesë e procedurës së prokurimit prandaj vlerësohet se është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

## VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Lidhur me aktivitetet të njëjtë të prokurimit është vendosur me vendimin me nr. 243/22 i datës 16.08.2022. Por pretendimet nuk janë të njëjta.

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.P.T. "F N W" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me spaleta ri-tender, me numër të prokurimit: 214-22-10000-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Policia Kosovës.

*[Signature]*

## **PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "N.P.T. " F N W" PRISHTINË**

### **Përgjigje në Pretendimi nr.1**

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të dosjes së tenderit, pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, raportit të vlerësimit dhe rrjedhës së procedurës së tenderimit sqaron si në vijim:

Sa i përket pretendimeve që kanë të bëjnë me matjen e gjatësisë së mostrave të cilave i referohet OE ankues, trashësisë së mostrave, ngjyrës së përdorur të penit, eksperti shqyrtues konstaton se nga vlerësimi i komisionit teknik sipas raportit të vlerësimit i përberë nga tre anëtarë të cilët edhe me herët kanë shërbyer si anëtarë të vlerësimit për tenderin e njëjtë i cili sipas eprokurimit është tender që në vazhdimësi tenderohet duke pasqyruar nevojat e AK-së.

AK-ja në dosjen e tenderit përveç kërkesës që malli të jetë në përputhje me specifikimin teknik ANEKS 1 në FDT është kërkuar që të dorëzohet edhe deklarata e përputhshmërisë së mallit të ofruar me kërkesat e specifikimit teknik.

Sipas dosjes së tenderit nën 3.1 Specifikacionet teknike të detyrueshme

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:**

- a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;

OE ankues në deklarata e tij për specifikimet teknike i referohet vetëm kualitetit të përshkruar në kërkesën e ANEKS 1 derisa nuk e konfirmon përputhjen me specifikimet teknike.

Deklarojmë se mostrat të ofruara në këtë tender janë të kualitetit si të përshkruar në kërkesën për ofertë ANEKS 1 dhe gjithashtu deklarojmë këtu se jemi të gatshëm nëse ka nevojë të bëhen ndryshime të nevojshme në dizajn ose ngjyra të produkteve sipas kërkesës së autoritetit kontraktues.

Ndërsa OE i cili është rekomanduar për kontratë në deklarata e tij sipas nenit 3.1 të dosjes së tenderit ka deklaruar.

Une person i poshtshënuar, përfaqësues i operatorit ekonomik që aplikon në tender (GRANIT ZHABARI B.L.) deklaroi se operatori ekonomik i plotëson të gjitha specifikacionet teknike dhe se ato përshkruhen në përgjithësi me specifikacionet e kërkuara.

Unë konfirmoj se kam lexuar dhe kuptuar plotësisht specifikacionet teknike të dhëna në dosjen e tenderit dhe siguroj se operatori ekonomik përshkruan maksimalisht me specifikacionet e kërkuara.

Unë pranoj sanksionimet e mundshme të cilat janë të shënuara në dosjen e tenderit dhe ligjet e kontratës, nëse produktet nuk janë në përputhshmëri me specifikacionet teknike të kërkuara.

Pasi kemi të bëjmë me matje milimetrike dhe pretendimet e OE ankues kryesisht janë për dallime milimetrike AK duhet pas pranimit të mallit të bëjë ateste në përputhje me nenin 37 të RRPP 0012022 të cilat e vërtetojnë përputhshmërinë e mallit të liferuar.

**Prandaj sa i përket pretendimeve të OE ankues që kanë të bëjnë me matjet eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi nuk është i bazuar.**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e paraqitur nga OE "N.P.T. " F N W" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me spaleta ri-tender, me numër të prokurimit: 214-22-10000-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Policia Kosovës.

Sa i përket pretendimit ankimor te OE ankues qe ka te beje me "yllat nuk janë te vendosur ne mesin e gradës" eksperti shqyrtues pas analizimit te dosjes se tenderit dhe specifikimit teknik te bashkangjitur dosjes se tenderit konstaton se OE ankues i referohet pozicioneve ne mënyrë te gabuar derisa ne specifikim teknik nuk është kërkuar ne mënyrë specifike "qe yllat te jene te vendosura ne mes te gradës" prandaj nuk mund te bëjmë një vlerësim te drejte te këtij pretendimi duke pas parasysh se kërkesa nuk përfshihet ne dosjen e tenderit.

Poashtu sa i përket dizajnit te spaletave te cilave ju referohet OE ankues eksperti shqyrtues konstaton se ofertat e OE-ve duhet te jene ne përputhje me përshkrimin ne specifikimin teknik te cilat e përcjellin çdo pozicion dhe se ne dosjen e tenderit **par. 21 "dokumentet te cilat dëshmojnë se Mallrat janë ne përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e specifikuara"** dhe nuk referohet ne asnjë rast ilustrimeve sikurse ne pretendimin ankimor te OE ankues.

**Prandaj sa i përket pretendimeve te OE ankues qe kane te bëjnë me vendin e vendosjes se yllave dhe dizajnin e spaletave te mbështetur ne ilustrime eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi nuk është i bazuar.**

Sa i përket pretendimit te OE ankues qe ka te beje me dizajnin e specifikave te shiritat e spaletave, dimensionet, emërtimet te kodeve te përdorura eksperti shqyrtues konstaton se specifikat teknike te dosjes se tenderit dhe pretendimet ankimore te OE ankues janë ne shpërputhje.

Për me tepër specifikimi teknik i bashkangjitur ne dosjen e tenderit e specifikon edhe standardet qe duhet përdorur dhe duhet te jene ne përputhje te plote me te gjitha standardet me rastin e liferimit te mallit. AK-ja me rastin e pranimit te mallit duhet te kërkoj te gjitha atestet sipas përshkrimit me poshtë ne specifikimit teknik ANEKSI 1.

#### **MATERIALI THEMELOR**

Specifikacionet Standardet Rezultatet

Përbërja: **ISO 1833** Fibre 1 : PES 55% ( $\pm 3\%$ )

Fibre 2 : **WO 45%** ( $\pm 3\%$ )

Ngjyra Kaltër e mbyllët, kodi **19-3934** , Pjesa e sipërme me lesh, Polister i gjysëm topitur,

Masa **ISO 3801** PART III 200 g/m<sup>2</sup> ( $\pm 5\%$ )

Diametri i fibrave të leshit **ISO 137** 21,5  $\mu\text{m}$  ( $\pm 1 \mu\text{m}$ )

Thurja Thurje e rëndomtë

Fijet për cm **ISO 2060** WARP: 35/cm( $\pm 1$ )

.....  
WEFT: 19/cm ( $\pm 1$ )

Forca e thyerjes **ISO 5081** WARP: min. 97 daN

WEFT: min. 49 daN

Cuklat **BS 5811** Pas 18.000 Cikleve: 5

Pas 36.000 Cikleve: 4-5

Rezistenca ne pastrim **BS 5690** 25.000 cikle

Relaksimi në tkurrje **SHIRLEY** WARP: min. 155°

WEFT: min. 155°

Stabiliteti dimensional pas larjes 40°C **NBN G 55-006 007** WARP:  $\pm 2\%$

WEFT:  $\pm 2\%$

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "N.P.T. "F N W" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me spaleta ri-tender, me numër të prokurimit: 214-22-10000-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Policia Kosoves.



Qëndrueshmëria ngjyrës në dritë EN ISO 105 B02 4  
Qëndrueshmëria ngjyrës në larje 40°C NBN G62 012 4  
Qëndrueshmëria ngjyrës në fërkim NBN G62 010 4  
Qëndrueshmëria ngjyrës në fërkim (të lagët) NBN G62 010 4  
Qëndrueshmëria ngjyrës në tretës organik NBN G62 013 4  
Qëndrueshmëria ngjyrës në djersë, acide dhe alkale NBN G62 011 3-4

Prandaj sa i përket pretendimeve të OE ankues si me lartë ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Vlen të theksohet se Operatori Ekonomik ishte eliminuar kryesisht për të njëjtat pretendime edhe gjatë procedurës tenderuese me nr. 214-22-3766-121 gjatë së cilës nuk kishte parashtruar ankesë.

#### **MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, dhe të vërtetohet Njoftimi për vendim i AK-se i datës 07.11.2022.

Autoriteti Kontraktues për shkak të prokurimit specifik duhet të kujdeset që fondet publike të shfrytëzohen në përputhje me nenin 1 të LPP-se në mënyrë që të gjitha mallrat duhet të jenë në përputhje me standardet e kërkuara për materialet themelore sipas dosjes së tenderit ANEKS 1.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- |                           |                      |
|---------------------------|----------------------|
| - Autoritetit Kontraktues | - NPT FNW.           |
| - Panelit Shqyrtues       | - OSHP.              |
| - OE ankues               | - POLICIA E KOSOVËS. |